



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Lënda: Kthim përgjigje.

Në përgjigje të email-it tuaj të datës 10.06.2025, me lëndë "Kërkesë për Informacion", protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë me nr. 1329 prot., datë 11.06.2025, ju bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 126/2020, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë" dhe ka si objekt veprimtarie rregullimin e sistemit të njësive të matjeve, standardeve të matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimit të sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.

Nga shqyrtimi i kërkesës suaj, konstatohet se ajo nuk është objekt i ligjit nr. 126/2020, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë".

Si rrjedhojë, ju sugjerojmë të drejtoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me adresë kontaktit, email: info@idp.al.

Ju faleminderit,